

COVID-19 – Siguria dhe shëndeti në Punë- Ndërtimtari dhe Ndërtim

Nën modelin e ligjeve rreth Sigurisë dhe Shëndetit në Punë punëdhësit kanë për detyrë kujdesjen ndaj punëtorëve dhe të tjerëve që ndodhen në vendin e punës për sigurinë dhe shëndetin e tyre në punë, dhe ku te jetë e mundur të eliminojnë ose të pakësojnë rreziqet.

Duhet të konsultoheni me punonjësit tuaj rreth çështjeve të shëndetit dhe sigurisë që kanë lidhje me COVID-19. Lejoni punëtorët t'i shfaqin pikëpamjet e tyre.

Distancimi Fizik

Duhet të bëni çmos që punëtorët të jenë së pakut 1.5m larg njëri tjetrit, për shembull:

- kufizoni shkëmbimet fizike – komunikoni duke përdorur metoda të tjera
- kufizoni numrin e punëtorëve në vendin e punës
- ndani turnet në para dhe pas dite
- pakësoni numrin e detyrave që duhen kryer çdo ditë
- lejoni të punojnë nga shtëpia kur të jetë e mundur
- krijoni udhë kalimi në vendin e punës që të ruhet ndarja fizike
- pakësoni numrin e punëtorëve në një zonë (sipërfaqe) duke përfshirë edhe gjatë kohës së ngrënjës së drekës dhe pushimeve të tjera të shkurtëra largoni karriget, tavolinat etj në dhomat ku pushojnë punëtorët
- mbani mbledhje online nëse është e mundur, nëse nuk është e mundur, mbani mbledhjet në vende të hapura dhe mbani punëtorët së pakut 1.5m larg njëri tjetrit.
- shtyjeni ndonjë trajnim që nuk është (domosdoshëm).
- vendosni pllakata (me informacion) rreth distancimit fizik kudo të vendin e punës

Duhet të menaxhoni rreziqet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë (p.sh pasojat që ka komunikacioni) që ndodhin për shkak të distancimit fizik.

Kontrollimet Shëndetsore dhe karatina

Monitoroni punëtorët tuaj për simptoma të COVID-19 si p.sh. ethe (temperaturë).

Thuaju punëtorëve, (nëse janë në vendin e punës apo jo) t'ju njoftojnë nëse ata:

- kanë simptoma
- janë ekspozuar një personi që ketëmund ta kishte COVID-19 (edhe nëse personi që dyshhet që mund të ketë COVID-19 nuk është testuar akoma)
- shohin një punëtor tjetër me simptoma

Ndaloni punëtorët, të mos punojnë nëse shfaqin simptoma.

Pastrimi

Pastroni shpesh me një detergjent (pluhur / lëng larë) ose dezinfektant:

- Sipërfaqet që preken shpesh – pajisjet, ashensorët, aparatet që ngrejné gjëra, parmakët (handrails), dhe dyert
- Gjërat personale si syzet dhe telefonat
- Veglat e punës siç janë mjetet e ndryshme
- Objektet e vendit të punë

Trejtoni punëtorët në pastrimin e pajisjeve, ta bëjnë menjëherë pas përdorimit.

Cilido që pastron duhet të:

- përdorin dorashkat
- përdorin dezinfektues me bazë alkooli para dhe pas përdorimit të dorashkave.

Koshat e plehrave duhet të jenë të mbyllur me kapak ku punëtorët mund të hedhin mbeturina si p,sh, letrat për fshirjen e hundëve, që kanë përdorur.(të pista)

Higiena

Punëtorëve duhet t'ju kërkohet që të mbajnë higjienë të mirë

- kur kolliten të kolliten në pjesën e mbrendshme të krakut ku është bërryli ose në tisuue
- të hidhen tissues sipas rregullave
- të lajnë duart shpesh me sapun dhe ujë për së pakut 20 sekonda dhe i thajnë ato tërësisht, edhe para si dhe pas ngrënjes dhe pasi shkohet në banjë (WC.)
- të përdorin dezinfektues me bazë alkooli
- të lajnë trupin, flokët duke përfshirë edhe mjekrat si dhe rrobat të lahen shumë mirë çdo ditë
- të qëndrojnë 1.5 m larg nëri tjetrit
- të rrijnë në shtëpi nëse janë sëmurë
- të mos prekin fytyrën
- të mos japin dorën dhe të shmangin kontakte të tjera të afërta trupore
- të mos pështynë
- të vendosin bishtat e cigareve mbrenda në koshin e plehërave

Banjot dhe pajisjes mbrenda duhet të jenë të pastra dhe të kenë sapun, uje dhe letër higjienike, gjithashtu sanitarizues me bazë alkooli për punëtorët për përdorim.

Dërgimet e mallrave dhe kontraktorë të tjerë që vijnë në vendin e punës



Nëse janë të nevojshme vizita në vendin e punës:

- jepni udhëzime të qarta në bazë të kërkesave tuaja, gjatë kohës që qëndrojnë në vendin e punës
- minimizoni numrin e punëtorëve që janë të përfshirë
- të keni në disponim dezinfektues me bazë alkooli për tu përdorur pas prekjës me dorë të mallrave që janë dërguar
- drejtoni shoferat e kamionave që vijnë duke u thënë të qëndrojnë mbrenda kamionit
- përdorni materialet elektronike, (në vend të letrës) dhe inkurajoni të tjerët t'i përdorin dhe përdorni diçka alternative në vend të firmave.

Informacione të tjera

Për informacione rreth shëndetit dhe sigurisë në punë, vizitoni uebfaqen [Safe Work Australia website](#)